Oral History Kosovo

INTERVISTË ME KUJTIM PAÇAKUN

Prizren | Data: 1 nëntor 2014
Kohëzgjatja: 100 minuta

Të pranishëm:

1. Kujtim Paçaku (I intervistuari)
2. Jeta Rexha (Intervistuesja)
3. Kaltrina Krasniqi (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:
() - komunikim emocional
{} - e intervistuara shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:
[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin
Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Fëmijëria

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për fëmijërinë e tij.]

Kujtim Paçaku: Jam djalë i katërt, i parafundit i familjes sime Paçaku, prej babës Durmishit dhe nënës Seime. Që të pesë fëmijë babai im na ka shkollu të themi me një pagë të atëhershme. Që të pestit jemi me diploma universitare. Mundemi rrallë me has tek komuniteti rom këtë shembull, falë çdo herë Zotit edhe babait tim i cili si telefonist i mirë fokusin kryesor, apo të gjitha paratë që i kishte i ka derdhë gjithmonë në libra dhe fletore për ne. Vëllau ka kry kimi- fizikën, motra ime e ndjerë e dyta ka kry ekonominë, motra ime tjetra Hamdia ka kryer ... është inxhiniere e diplomuar, pastaj unë, dhe e ndjera motra ime tjetër ka kryer anglishtën. Do të thotë tani jemi dy vëllezër e një motër.

Fëmijëria ime ka qenë e bujshme, nxënës i shkollës fillore, nxënës i cili vraponte pas muziktarëve në rrugë ku gjejshim dasma (buzëqeshë). Fëmijë i cili vraponte pas topit, apo para topit, prisja topin. Kur them prisja topin atëhere, mendoj që kur do të jetë koha të dilja unë para topit t'a pres kur do të vijë topi. Nuk ka qenë aspak e lehtë të inkorporohemi në sistemin e shkollave të atëhershme sepse në shtëpi e flisnim gjuhën rome, ndërsa në shkollë në ora 11 u bënim gati ta flisnim gjuhën tjetër - gjuhën shqipe (buzëqeshë). Për fëmijët e komunitetit aspak nuk është e lehtë kur tanë kohën për gjashtë vite, shtatë vite folë në shtëpi gjuhën rome, e pastaj në shkollë gjuhën shqipe. Që për fëmitë e komunitetit rrallë ka ndodhë, sepse ka pas fëmi të gjeneratës time që në shtëpi kanë folë gjuhën shqipe, kanë shku në shkollë ne gjuhën shqipe, s'ka pas problem, apo në turqishte, të flitet në shtëpi turqishtja, e të shkohet në shkollë në gjuhën turke, por tek ne ka qenë disi më specifike për ta kriju bazën, themelin e shkollimit fillor sepse e para duhet të flitet shqip në shkollë.

E mira është që nëna ime e ndjerë më thoshte apo bisedonim kur unë jam rritë, më thotë, "S'të kam rritë të bahesh egoist". Thom, "Pse egoist?" Po më thotë, "është filozofi e mirë e fëmiut që kur thithë gjirin e nanës, është egoizëm i madh nëse thithë vetëm qumshtin e nanës nga gjiri i saj". E ne kemi thithë edhe gjuhën (buzëqeshë) e na e paralelisht domethanë kemi ba dy veprime – të thithësh gjirin e nanës edhe në ndërkohë të thithë edhe gjuhën e nanës, them të thithë gjuhën e nanës duke i ndëgjuar këngët e saja, duke i ndëgjuar rrokjet e saja deri sa të vinte në gjum apo këngën e saj. Ndërsa, paralelisht i bënim dy veprime. E kjo është de fakto politikë e komunitetit rom që asnjëherë të mos bahen egoistë, fëmijët e komunitetit rom të bëhen egoistë të thithë vetëm gjirin e nënës edhe asgjë tjetër. Qumështi mund t'i rrjedhë dika këndej {tregon faqen e fytyrës} edhe nëna të i'a fshijë edhe t'kalon ajo etapë. Jo! Paralelisht duhet të thithë edhe gjuha e nanës, mendoj për gjuhën rome.

Kështu që një fazë kaloi, duke përvetësuar gjuhën. Më pas fillojnë hapat e para për ta përvetësuar edhe gjuhën e dytë, shqipen, sepse duhet të shkollohesh në gjuhë shqipe. Duke përdorur nga mosha tre, katër vjeçare "Mirëdita", "Mirëmëngjes," jo nuk është mirë. E tani dil prapë jashtë trokit në derë të thuash,

“Mirëdita”, kështu bënte vëllau im, nëna ime, motrat e mija që ishin më të vjetra dhe zhvillonim gjuhën shqipe.

Është e mirë që unë gjatë shkollës fillore kam ditë të boj' një auto-operacion tek unë, të them “Po, unë jom rom” (buzëqeshë), sepse shumica e atëhershme e viteve '65, '66… kur unë kisha shtatë vite, atëherë s’jam friguar fare të them se jam rom. Pozita ekonomike e romëve të tjerë ishte shumë e vështirë. Më kujtohet mësuesi, “Shkepni ndihma!”, s’di çfarë ndihma ipshin. Edhe po pyet, “A keni nevojë për ndihma ju?” “Jo, jo, s’kemi nevojë për ndihma, ne jemi të pasur. Kemi radio në shtëpi”. E kishim radion në shtëpi edhe në mledhje të prindërve, mësuesi i tregonte babait, i thoshte “Shiqo i kemi disa donacione të Kryqit të Kuq, më duket të japin sheqer, vaj...” Unë tepër kom qenë i prekur kur mësusi më tha para shokëve, “Mos keni ndihma edhe ju Kujtim?” Thash, “Jo, jo, ne kemi radio në shtëpi, s’jemi fukara”.

Ajo radio ime ka qenë “Melodia”, babai e kishte atëherë ... apo “Toplica” nuk di nëse ishte “Melodia,” apo “Toplica”. Ishte një rreth i madh sikurse kompas, ndëgjonim atëherë kangë jashtëzakonisht t’mira diku kah pasditja, shumë pak rome, po oh Nexhmija po këndon. Nexhmije Pagarushën duhet me e ndëgju, apo ndonjë muzikë turke apo mos dhashtë Zoti ndonji kangë rome kumedit ku ka mujtë me gjetë. Ka qenë për ne n’shtëpi dasëm kur ka muzikë ka ora pesë pasdite, apo t’i ndëgjonim përshëndetjet dhe urimet, kur zëri buçiste i radios (buzëqeshë), po, jo mirë.

Shkoi shkolla fillore. Kam qenë i mirë, aktiv mjaft kam qenë edhe në aktivitetet e lira. Në moshën dhjetë apo nëntë vjeçare jam paraqitë për herë të parë në televizion. Në aktivitetet e lira kam pasur të veshur... garderoba, kostumografia shqiptare por kam kënduar në gjuhën serbe. Kam kënduar një këngë të një këngëtari jo serb në emisionin “Shkëndija” e atëherëshme e Prishtinës. Kam parë veten në televizion duke kënduar, ishin garat e shkollave fillore. Më kujtohet se kam marrë vendin e parë ku i atëhershmi një politikan, besoj se më kujtohet, Fadil Hoxha më dha një dhuratë, por dhurata nuk mbaroi në duart e mija, por ngeli në shkollë. Më pas unë nuk ia ktheva një top shkollës në orën e fiskulturës. Thash, “Ma kanë dhonë dhuratën, tash unë po marr topin se s’ka këndu as drejtori as mësuesi. Kam këndu unë, dhuratën duhet ta mbaj unë. Shkolla s’ka këndu, kam këndu unë”. Se s’kom pas dhuratë asnjëherë. Por e di që një herë m’kujtohet në Shtëpinë e Kulturës kam këndu një këngë ku edhe nxënësit e shkollave fillore atëherë kanë këndu disa kangë. E di që jam shpërblyer, vetëm e kam parë Fadil Hoxha kur ma ka dhuruar atë dhuratë, për mu ka qenë... Por as atë dhuratë mo s’e kom pa unë. Edhe unë në orën e fiskulturës, futbollin nuk iu a ktheva shkollës. Askush s’ma ka lypë më topin, kemi lujtë gjithë fëmijët e rrugës. “Është kjo dhuratë,” thom.

Që atëherë kam fillu edhe të zhgaravis nëpër fletore, ndonji poezi për shkollën për mësuesin. Mësuesi ishte i kënaqur... “Po, po vazhdo, Mehdi Cufi, do t’bëhet diçka...” Ishte një sistem interesant në shkollën fillore ku nxënësit e dobët që tregonin sukses të dobët gjatë ditës, ata qëndronin plus edhe një orë për të bërë përsëritjen e njësive mësimore nga e kaluara e ditës. E shpesh kam qenë unë ai që i ka mbajtë orët plotësuese për nxënës, ku në klasën time kishim edhe përsëritës shumë ma t’vjetër se unë, unë '59 ata sigurisht ishin '50. Hamza nji klarinetist i mirë, shpesh... e kisha rolin e mësuesit në klasën e katërt a të pestë, “Mos më pyet mu”, më thoshte në gjuhën rome, i vinte keq (buzëqeshë). Nga landa e matematikës apo gjuhës, mësuesi më angazhonte që të bëja mësimin plotësues nji ose dy orë.

Futbolli ka qenë pjesë e pandarë, e prisnim të shtunën, të dielën ku futbolli ishte i pashmangshëm, domethonë kemi qenë të gatshëm edhe ushqimin ta banim [merrshim] me vete edhe të bahet festë e futbollit. Shëtitjet më kujtohen të klasës së parë ose të dytë kur dilnim prej Prizrenit, shkonim në Parkun e

Qytetit i cili ishte në hyrje të Prizrenit, tani më janë ndërtesa aty. Karakteristikë e madhe ishte e imja ku gjyshja ime më turpëronte ndonjëherë sepse shkonim larg dy nga dy edhe këndonim, “Erdh pranvera, erdh pranvera në kopshti e lule tjera, manushaqja sa ka çelë dhe bylbyli sapo del”. Unë qëndroja i fundit në rresht ndërsa gjyshja ime ndjerë pastë Raza, ajo më mbante në shpinë. Vinte (qeshë) më mbante në shpinë, isha i fundit edhe i thoshte mësuesi, “Pse po vje ti gjyshe ta ban [mbajë] Kujtimin në shpinë?” “Jo, jo djali m’lodhet se une duhet ta mbajë në shpinë. Po m’trego kur ktheheni”. Mësuesi i thoshte, “Ka ora katër dkur.” Gjyshja kthehej në shtëpi, krynte punët e shpisë edhe më prite te cepi i parkut ku do të kthehemi prapë unë gjyshes n’shpinë. Kështu që kur kishim shëtitje (qeshë) mu më vinte marre prej shokëve sepse shokët tjerë ecnin, këndonin, po edhe unë këndoja në shpinën e gjyshes. Ndonjëherë i thosha, “Po gjyshe a din edhe ti me këndu ndonjëherë?” Thojke, “S’ka nevojë të këndoj, unë do t’barti ty". Edhe ushqimin çka kishim. Edhe në të shkuar edhe në të kthyer unë gjyshes n’shpinë, e përqafja me dy duar më barte, kështu më kujtohet fëmijëria, interesante ka qenë.

Kisha përkrahjen e motrave, të vëllaut... Pak kam ndejtur në rrugë, është karakteristikë te romët sepse ata e kanë nji skutë diku nëpër rrugë ku qëndronin, unë nuk kam pas të drejtë me ndejtë aty. Vëllau nuk fliste, vetëm me kokë thoste {lëvizë kokën}, lëvizte kokën, duhej të shkoj në shtëpi edhe mësim. Po nuk bohet mësim në shkollë. “Mëso!” Tani po e logjikoj unë... Ku bon n’shkollë mëso? Po eja shiqo a po mësoj unë, munem me ndejtë në dhomë katër – pesë orë, gjashtë muj, me fjetë, po hajde... me mësu, mësu, mësu! Isha i mirë në shkollën fillore.

Rinia

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për rininë e tij.]

Kujtim Paçaku: Çka ndodhë pastaj? Drejtori i shkollës së medicinës, i pranuar në shkollë të medicinës. Për t’gjithë ishte spektakël, Kujtimi do t’bahet mjek. E thash, “E çka do t’baj unë mjek?” Por gjyshja ime dinte të bënte më tepër se 30 lloje të barnave popullore. Shifja gjyshen, po i shnoshë njerëzit, edhe unë do t’i shnosh. Po si? Ajo po i shëron gratë, fëmitë e mahallës me disa barna, me disa ilaçe, me disa lule. Vazhdova një javë apo dhjetë ditë në medicinë, ndrrova mendjen. Thash, “Nuk është për mu ktu”. U drejtova ksaj rruge mbrapa që e kemi [i referohet rrugës pas objektit ku zhvillohet intervista] në shkollën e muzikës. Muzika ishte për mu ilaç, ishte medikament e cila m’qetësonte, rikthehesha mrapa duke dëgjuar radion. Thosha, “Prej këtu del muzika, prej këtij radios. Këta njerëz ktu e bajnë muzikën”.

Shkolla e muzikës është shkollë specifike ku ka edhe mësim individual edhe mësim grupor. Falë stafit që atëherë ishte jashtëzakonisht i mirë, më kanë përkrahur shumë me koncerte, me këndim koral. Tanë ditën shkolla e muzikës kërkonte punë sepse unë piano në shtëpi nuk kisha. Paradite mbaja mësimin e rregullt, pasdite mësimet individuale edhe ishte luftë e madhe për ta zënë një dhomë ku ishte pianoja për të ushtruar. Edhe teta Lizë e cila pastronte shkollën, ne i ndihmonim, unë i ndihmoja shumë për ta pastru ma heret lokalin apo zyret ku ishte pianoja, ajo shkonte në shtëpi. Unë qëndroja deri në dhjetë, në njëmbëdhjetë në mramje në piano. E mbyllja derën edhe hedhja çdo herë n’mramje çelësat prej derës apo mbi mur i hedhja në oborr, ajo i gjente n’mëngjes, vinte prapë vazhdonte kështu që askush nuk e ka ditë këtë (buzëqeshë). Profesorët më kanë përkrahur shumë sepse kanë ditë që nuk mungon talenti tek unë. Kam punuar në mënyrë jashtëzakonisht serioze. Po fatmirësia ime që prindërit e mi s’e kanë ditë muzikën me nota, asgjë në shtëpi, sepse unë kom qenë muzicienti i parë në shtëpi, edhe s’kanë ditë asgjë të më pyesin në kontrapunkt, në harmoni, në solfegjo, e kështu me rradhë... (qeshë). “Po, mirë është, vetëm spjegoje në të kënduar....” e kështu me rradhë, nuk desha të ndalem asesi.

Fillova edhe studimet e Akademisë së Muzikës, Akademi e cila ka qenë e përshkallëzuar në dy etapa, dy vitet e para ishte shkalla e parë, pastaj provimet pranuese në shkallën e dytë, katër vite me 56-57 provime. Por aty hasa në muzicientë jashtëzakonisht të mirë: Nezafete Shala, Gani Miftari, Shaban Kelmendi, Shefqet Hoxha, Jasmina Omeragic, Lejla Pula Haxhiu. Jashtëzakonisht t'mirë, paraardhesit e muzicientëve sot...Venera Mehmetagaj. Na bënim edhe muzikë popullore, edhe ishte festë kur profesori ndonjëherë thoshte, "Po, sot nuk do të zhvillojmë njësinë mësimore por dëgjojmë një grup, një kuartet apo kuintet". Na pëgatisnim në mënyrë idioteske vepra të Betovenit dhe i shndërronim në popullore disi, e adaptonim, apo të Lisztit apo Chardash.

Ishte çdo ditë festë në shkollën tonë të muzikës, e pritja që çdo ditë do t'bënim muzikë edhe me këngëtarë jashtëzakonisht të mirë. Gjatë studimeve kam qenë anëtar i Kolegium Kantoriumit të cilën e udhëheqte i ndjeri Mark Kaçinari. Me 100 këngëtarë të jesh za tenori i parë, ka qenë privilegj për mua të këndoj Ljede Mjedën, Gani Myftarin apo me Shaban Kelmendin, ku ata jo që studionin zërin, ishin këngëtarë operistikë. Më pas krijohet edhe orkestra – Ansambli i studentëve nën drejtimin e profesorit Fahri Beqiri. Janë momente interesante kur zakonisht piqesh si bukë në furrë. Dy – tre vite kam qenë anëtar i Kolegiumit, anëtar i orkestrës së studentëve dhe n'atë periudhë nën drejtimin e profesor Kaçinarit, ne kemi marrë dy – tre herë vendin e parë në garat korale të Dubrovnikut. Kemi qenë jashtëzakonisht të mirë, edhe filloi me kompozimet e para në Akordet e Kosovës.

Tanimë muzika fillon t'i lshon celulat e para në mu, edhe pse më parë në Prizren baheshin festivale të ndryshme. Gitariada është një rock festival kom këndu në gjuhën rome atje. Kam qenë i njohur në shoqatat kulturore artistike që edhe sa isha në fakultet për shembull, kam qenë anëtar i Shoqnisë Kulturore Artistike "Agimi". Kam kënduar nën drejtimin e profesorit Dashnor Xërxës. Më pas kam qenë anëtar i Shoqërisë Kulutore Artistike "Dogrioll" tek turqit. Kam qenë pjesë e orkestrës në klaviaturë, edhe kur kemi bërë inqizmet e para turke të muzikës turke, po mendoj një pjesë goxha e madhe. Dy – tri vitet sa isha student kom qenë pjesë e "Dogrioll-it".

{Thotë lutjen kur dëgjohet lutja e hoxhës} Unë, gjithmonë kur këndon ezanet ndalem dhe e këndoj atë lutje (qeshë). Edhe çka më pas...? Akordet e Kosovës ishin për mu ngacmim thosha. Po për mu si student do të tentoj të shkruaj. Asht' shumë interesante, do t'ju tregoj tani, që asnjëhere nuk është dhënë rasti të bisedoj, për shembull, Emine Asimi "Takime te burimi" është një këngë e imja. Asnjëhere s'kam ndejtur me Emine Asimin edhe pse jam kompozitor i asaj kange, as në prova, asnjëherë... Vjen festivali i ardhshëm, "Kemi dasëm në malësi" këngë e kënduar nga Nazmie Dushollovci, unë asnjëherë Nazmijen s'e kam njoftuar.

Sukseset kanë qenë të mira kur shembull Emine Asimi këndon këngën "Takime te burimi" edhe sistemi i votimit për këngën më të mirë ka qenë përmes radiove qendrore të atëhershme të Prishtinës dhe radiostacioneve lokale. Njëzet këngë, kur Bashkim Paçuku merr vendin e parë, këndon "20 vitet e festivalit" të Musa Pjarkut, çdo radistacion jepte prej një deri në dhjetë vota. Unë kisha vendin e pestë. Disa këngëtarë tani s'dua t'i përmend që kanë qenë të gjashtë e më poshtë sipas votave, unë vendin e pestë. Asnjë këngëtarë s'e kam njoftur, s'kemi ndejtë të pijmë kafe asnjëherë as me Nazmijën as me Emine Asimin. Po nejse...
Për mu ishte një satisfaksion shumë i madh që vazhdoj ende punën gjatë studimeve, mos ta ndërprej aspak edhe unë e kreva Akademinë e Muzikës. Filluan trazirat. Filloi situata socio-ekonomike të jetë ma e tendosur sepse në familje tani veç ishim pesë studentë. U detyru edhe nëna të punësohet që t'i mbaroj

studimet. Filluan pothuajse... hajde të kqijat, humba motrën e vogël në moshën 28 vjeçare nga kanceri në këmbë. Diçka nuk na shkoi mirë. Më pas, kaloi një kohë e gjatë që unë nuk u pajtova me atë realitet.

Fillova të shkruaj. Unë edhe paralelisht derisa isha student në Prishtinë kam shkruajtur vjersha kam bërë këngë në gjuhën rome, kam qenë anëtar i Shoqërisë Kulturore Artistike "ROM" të romëve në Prishtinë. Kam formuar oktetin, nji oktet edhe pothuajse edhe nji kor, ma i madh se okteti, edhe kemi kënduar këngë në gjuhën rome në Prishtinë derisa isha student kishim shfaqje. Atëhere u mbajke edhe një festival i takimeve të romëve të ish-Jugosllavisë në Prishtinë. Është mbajtë takimi i pestë ku kam pas rolin e drejtorit artistik të atij festivali. Edhe fillun në ndërkohë celulat e para të organizohemi përmes një fletushke ku bëhen poezi. Kshtu që e prezentum atëhere edhe folklorin rom edhe poezinë.

M'kujtohet si student kam qenë i angazhuar edhe në Gerçek [për të vërtetë] të shoqatave turke në Prishtinë. Dimërat ishin jashtëzakonisht të fotftë. Kur të gjithë vinin në shtëpi, unë duhesha të ngelja në Prishtinë. Kthehenin nëpër shtëpijat e tyre studentët gjatë vikendit. Më duhej të rrija në Prishtinë, ia kisha inatin baltës... uhh (buzëqeshë). Stacioni i trenit ishte dikun te 21-shi, pak më larg. Më kujtohet shumë herë me ato çantat niseshim në stacionin e autobusave, "Sot nuk ka asnji autobus për Prizren. S'ka më vend. Merr nji biletë për vikendin tjetër". Duhet të kthehesha prapë apo të vinin prindërit t'më vizitonin. Kisha edhe një bursë, babai ma bleu një palltë këtu. Unë e mora bursën, s'i tregova që e mora bursën, e unë e bleva një palltë. Ai vinte me një palltë në vizitë edhe une një palltë tjetër. Nejse, e ktheva atë palltë.

Shpesh shkoja në Beograd për ta përcjellë ndonjë koncert apo në Zagreb për ta përcjellë ndonjë koncert. Kshtu që ishim një grup i studentëve që shkonim edhe në qytete të tjera, qoftë në Shkup për ta përcjellur operën "Zhizela" të Berliozit, apo ndonjë vepër tjetër. E kishim këtë por nuk e linim edhe në qoftë se është ndonji eveniment i sportit, zakonisht i futbollit. Atëhere ishte asisoji të përcillnim Prishtinën kur luante në Beograd, apo të shkonim për Prishtinën kur luante në Zagreb se për ne ka qenë... Apo "Liria" e atëhershme që çdo herë kam qenë prezent në ndeshjet e futbollit, zakonisht në Prishtinë kur luanin sepse baba ishte ai që bënte ndërlidhjen e telefonave për t'u bërë transmetimi në sistemin telefonik. Unë qëndroja shpesh pranë Veli Vraniqit i cili komentonte, apo Azem Brovinës i cili komentonte për radio, komentonte ndeshjen. Për mu ka qenë çdo herë festë e madhe të rri pranë Azem Brovinës. Aty fillun edhe të them "Uh sa mirë të jesh gazetar".

Bëra disa artikuj, ke një artikull i vogël në Rilindje, "Uh" thash "mirë është të jesh edhe gazetar". Edhe une e kuptoja çdo ditë më mirë gazetarinë edhe i thash vetit, po, është ky zanat? Është ky zanat, zeje. Në qoftë se din ta punon mirë... lypë kreacion. Edhe Prishtina më ngelë kujtim shumë i madh se kom dhanë kontribut mjaft edhe në shkrime. Pason periudha e APJ-së, Armatës Popullore së Jugosllavisë ku kom shërby nji vit e gjysëm. Atje prapë kom krijuar grupin e korit, osht' qendra e pestë ushtarake e Kroacisë.

Kom shërbyer edhe në Varazhdin (qytet ne Kroaci), unë atëhere kam marrë vendin e parë në gara, edhe tanë kohën kam thanë, është nji artikull në gazetë "Ushtari sikurse Herbert von Karajan". Kemi dirigjuar në ushtri dhe kemi e pruar me nji shkollë "Divizioni i 32-të" quhej shkolla e mesme e Varazhdinit, ku prej asaj shkolle kemi huazuar nxënëset, e unë kisha ushtarë të cilët këndonin në kor. Për mu ish një eksperiencë jashtëzakonisht e mirë e muzikës. Më pas fillojnë të derdhen poezitë në kokën time...

Eh tani periudhë e vitit '86 ku po më duket se ai vit ishte hapja e dritareve të mia në art, në poezi. Në Beograd mbahet shkolla e parë internacionale rome, ku tubohemi të gjithë njerëzit me fakultete dhe bisedojmë sesi fillojmë të krijojmë celulat e para të re-socializimit të komunitetit në suazat e arsimit. Edhe

pse më parë harrova të ju tregoj që nga mosha 10 vjeçare unë isha anëtar i shoqatës romëve. Viti '86 në Beograd, intelektualat të asaj kohe të atëhershme tuboheshin në shkollën internacionale të romëve ku për herë të parë kam pas rastin të takoj të gjithë intelektualët romë nga Europa. Dhjetë ditë shkollë intenzive e gjuhës rome standarde, e kulturës traditës dhe historisë.

Intervistat e para, poezitë e para filluan të derdhen... sepse nga ai takim i parë, dolën edhe antologjitë e para. Kisha disa shënime në fletore me vete, edhe disa u pëlqyen, disa jo. Qëllimi nuk ishte të hy në antologji, qëllimi ishte që unë të tregoj diçka nga Kosova që kam punuar, sepse që nga fëmijëria unë kam qenë anëtar i shoqatës "Durmish Aslano" të Prizrenit – Shoqërisë Kulturore Artistike. Durmish Aslano është një hero rom i atëhershëm dhe Shoqnia e trashëgon emrin e tij. Kam qenë në orkestër me violinë të Shoqërisë Rome "Durmish Aslano" ku kërkoja çdo herë t'i kemi n'orkestër tri-katër-pesë violina, t'mos jetë më si orkestër. Për disa kolegë ka qenë e pakuptushme, a din... tri-katër-pesë violina... kërkoja një standard të mirë të orkestrit ashtu si isha mësuar unë në shkollë.

Nji antologji e cila botohet një poezi, dy-tre të mijat atëhere ishte shtytje e madhe për mu që unë të filloj të shkruaj. Atje njoftoj një profesor i cili në të ardhmen do të ishte mbështetës i imi shumë, apo i tërë popullatës rome në përgjithësi të Europës – Marsel Kortiade, i cili në mua sheh një poet të ardhshëm, në mua sheh një intelektual të ardhshëm. Edhe më pas fillon karavani i poetëve vite në vite në qytetet e ndryshme të Europës, qoftë në Poloni, qoftë në Sllovaki, qoftë në Pragë, qoftë në Gjermani, qoftë në Paris e kështu me rradhë në shtetet aty ku kishte interesim për t'u mbajtur shkollat verore të romëve. Kështu më takoi rangu i etnomuzikologjisë edhe i gjuhës standarde rome.

Aktivizmi

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për periudhën e aktivizmit.]

Kujtim Paçaku: Në '91 më filloi edhe më fuqishëm të punoj në ngritjen e emancipimit të komunitetit rom. Jam anëtar i kongresit të pestë të romëve, ku është mbajtë në Poloni në Varshavë ku bisedohet për standardin e gjuhës rome. Më pas pasojnë edhe kongreset tjera me rradhë. Dita ditës unë furnizohesha me literaturë, me gazeta të ndryshme edhe përcjellja aktivitetet, i promovonim aktivitetet e romëve tjerë në Kosovë. Aq sa afroheshim viteve '98-'99 shifej se po ngushtohet rrethi edhe për ne, më pak koncerte, më pak aktivitete; ajo hetohej disi. Nuk di sa unë duhet të flas për periudhën e viteve që njerëzit pak kanë dëshirë të flasin për ate.

Kaltrina Krasniqi: Çfarë kanë qenë vitet e '90-ta për komunitetin rom?

Kujtim Paçaku: '90-tat edhe aty fillon të ngushtohet rrethi edhe për ne, sepse edhe pse ishim aktivë në aktivitetet kulturore, në aktivitetet të cilat përbënin në vete muzikën, poezinë, prozën e kështu me rradhë, hetohej se po ngushtohej rrethi edhe për mjete financiare që të zhvillohen aktivitetet edhe për takimet rreth romëve. Ndërsa, romët tjerë filluan të bënin aktivitete më të bujshme atëhere jashtë Jugosllavisë së atëhershme. Vlen të përmendet se Prizreni, në atë kohë diktohej që Prizreni po jet' një fidanishte e intelektualëve. Vitet e '90-ta hasim mbi 28 romë dhe rome me diploma universitare. Vetëm katër-pesë i kisha unë në shtëpi, ishim (buzëqeshë). Edhe kishim prokurorë, profesorë, mjekë, inzhinierë, gjykatës e kështu me rradhë.

Nga kjo del që sot në shtetet e Europës nuk mund të paramendohet asnjë shtet i Europës nëse në vete nuk e ka një rom nga Prizreni. Kur në takim takoheshim shembull në kongresin e shtatë, jo larg, është mbajtë në Zagreb edhe në nji takim qëndronim pesë nga Prizreni. Njeri përfaqësonte Kroacinë, tjetri Holandën, tjetri Belgjikën, tjetri Gjermaninë e tjetri Kosovën. Po mirë... të jemi tre nga një rrugë është edhe më interesant tani. Aty shifej që çdo herë romët nga Prizreni, kryesisht të themi nga Kosova, sot e kësaj dite, mbajnë pozitat më të larta në asociacionet e romëve.

Qoftë në aspektin politik, ekonomik, social, kulturor zakonisht ne ktu jemi farkuar, shumë mirë jemi farkuar me relacionet që i kishim shumë të mira me profesorin, me mësuesin, me shokun, me gjuhën... sepse Prizreni ka dhënë mjaft për gjuhë. Në nji takim unë me njerëzit eminentë të Sorbonës kur bisedonim, rektori kishte dy fëmijë- njënin 12 tjetrin 18 vjet edhe bisedonim për fëmijën e vogël të tij. Me pyste "Sa vite i ka i yti?" "I imi ka 12. Po i yti?" "Edhe i imi ka 12". Thosha "Sa gjuhë flet i yti?" Thotë "Vetëm frëngjishten", thom "I imi flet katër gjuhë". Këto Prizreni i jep, sepse flasim romishten, shqip shkollohemi, shumë shpejt ndërkohë msohet serbishtja apo boshnjakishtja. Edhe n'Prizren t'jetojsh e mos ta dijsh turqishten (qeshë) është pak si e paevituar.

Kaltrina Krasniqi: Çka e ka shty emancipimin e romëve n'Kosovë? Çka ka qenë, çka e ka stimulu?

Kujtim Paçaku: Vetëdija nacionale! Në vitin 1969, bëhet një revolucion kulturor në Kosovë. Krijohet organizatat e para kulturore. Si e përmendëm "Durmish Aslano" në Prizren, Shoqata Rome në Prishtinë, "Nerudimka" në Ferizaj, njëra në Pejë e kështu me rradhë. Çka ishte që në '86-tën, unë jam i pari që hap dyert e radios, këtë ishte e paevituar në Radio Prizren. Fillon emisioni i parë në gjuhën rome ndoshta edhe në Europë. Edhe pa kurrëfar' bllokade para veti, në emisionin e parë unë kam thënë "Lacho dive romalen me se e Durmishesko chavo o Kujtimi, ka kerva i emisija pi rromani chib!" "Mirëdita njerëz, unë jam Kujtim Paçaku, djali i Durmishit dhe do të fillojmë emisionin në gjuhën rome".

Në '86-tën ka qenë 7 korrik kur ka dalë emisioni i parë, kur dikush në Prizren apo diku tjetër prej romëve pak e lëshonin radion që të mos kupton komshiu tjetër që është rom (buzëqeshë). Në ''86-tën ka pasë edhe njerëz të cilët e kishin një paravënë para vete, ishin ma të bardhë se unë, ishin ma të pasun se unë, e s'kanë pas aspak leverdi që ta tregojnë veten që janë romë; por unë këtë e bëra se isha edhe me Akademi edhe redaktor i katër redaksive, redaktor i muzikës.

Çka ndodhë më parë? Në '86 unë kam qenë mësues, arsimtar i diplomuar në shkollën fillore "Abdullah Shabani" në Duhël edhe në Bllacë. Çdo ditë kam udhëtuar dy herë nga 28 kilometra të ligjëroj, të maj mësim të muzikës edhe të edukatës fizike edhe disa orë plotësuese të gjeografisë. U paraqita në konkurs të atëhershëm, edhe jam pranuar si arsimtar do t'thotë si absolvent edhe si profesor në shkollën fillore "Abdullah Shabani". Kam punuar si arsimtar, kam mësuar çdo ditë, kam krijuar korin e shkollës, jam marrë i pari me aktivitetet kulturore në shkollë ku kom kriju orkestrën e çiftelive apo të sharkive, çdo instrument ka qenë pjesëmarrës në orkestër për nxënës. Kemi kënduar këngë në gjuhën angleze me fëmijë, disa herë kemi marrë vendin e parë në garat komunale të Suharekës.

E shifja se shkolla ka një pjesë të fushës me kollomoq, me misër, të dieleve kemi organizuar takime me nxënës vullnetare me sopatë, shat e kështu me rradhë. Edhe tërnakop çka ka pas i kemi rregulluar fushën e sportit, e kishim problemin e shtyllave. Hajrushi atëherë kujdesej për pyjet përreth Dulës dhe Bllacës, nuk na jipte mundësi t'i marrim shtyllat, t'i presim tre-katër dru, t'a bëjmë shtyllën. Atëherë, jemi dehë mirë te, e kemi ne nji kafe kemi pi me të mirë. Ndonjiherë pija gotën me ujë dhe i thoja "Hajde për t'mirë".

Ai me alkohol unë me ujë, derisa e kemi dehë mirë dhe i kom dërgu nxanësit në pyll. Kanë marrë drutë pa ditë ky fare, se tanë kohën, tanë ditën e kam majtë aty "Hajrush të lutem na mundëso në shkolla" në negociata, "na mundëso që t'i marrim drutë, t'i bajmë shtyllat". "S'bon" thojke, "i shtetit osht', nuk osht' e jemja private. Me qenë e jemja merrni, po e shtetit nuk e jep". Po nejse, na i murrëm ato shtyllat, të nesërmen i dërgum i përpunum shtyllat.

Kemi bërë aktivitetet e para, turniret e para të futbollit të katër shkollave paralele në Duhël, Bllacë, Javor [qytet] edhe Grajçevc m'duket po... Edhe fillum aktivitetet e para sportive në Duhël edhe në Bllacë, pesë vite kanë qenë vitet ma t'mira të rinisë sime, kur unë kam punuar si arsimtar atje. Vrapimet, krosi pranveror, vrapimet... vajzat e dinin që në orën e edukatës fizike duhet të kishin patikat. Mos t'flasim për mashkujt, për djemtë të klasave të shtata të teta, duhet të kishin trikot e tyre, të jenë në maicën e bardhë, brekët e zeza dhe të luajnë futboll përndyshe pak ka pas prej tyre.

Edhe kanë fillu talenta shumë t'mirë në futboll, krahas asaj unë jam shumë i lumtur që kemi kriju edhe Shoqërinë Kulturore në Bllacë "Avni Rrustemi" me iniciativën time. Edhe fillojnë këngëtarët jashtëzakonisht të mirë të dalin, Sale Bekteshi të cilën menzi e kam marrë për dore në klasën e katërt. Më kujtohet "Do t'këndon!" "Më vjen marre". "Do t'këndon!" "Më vjen marre". Sale Bekteshi, Sehije Hoxha, Violeta Suka të gjithë këngëtarë që kanë premtu dhe kanë inçizimet e tyre, këndojnë.

Pothujse isha pjesë e atyre fshatërave ku përditë udhëtonim, bënim aktivitete, ndodhej që dy-tre netë nuk kthehesha n'shtëpi. Kisha vend te shokët e mi ku flija sepse aktivitetet tjera na pritnin, garat komunale kështu me rradhë... Kemi bërë aktivitete jashtëzakonisht të mira. Sot edhe kësaj dite, kur udhëtoj në rrugën e vjetër Suharekë-Duhël n'anën e majtë shiqoj fushën që ne e kemi punuar, edhe të volejbollit edhe të futbollit. Shpesh fotografitë e mija janë kujtimi ma i madh me nxënës në aktivitetet e lira.

Po, e tani po i kthehemi ksaj periudhe të radios deri në vitin '98 apo gjysmë '97 unë kam bërë 999 emisione të drejtpërdrejta në radio. Asnji emision nuk ka qenë i punuar apo i montuar më herët. Kam dashtë të punoj emisionet, kam filluar me një 15 minutësh deri në 11:15, emisioni quhej "Lago Di Vero" (liqeni i vertete) Malen [e pakupt. 11:51] që i bjen "Mirëdita romë". Më pas me termin më t'gjatë, nji herë në javë nga 30 minuta, derisa mërrinëm në çdo ditë i kemi nga 60 minuta të emisioneve.

Kaltrina Krasniqi: Me çka mirreshit me këto emisione?

Kujtim Paçaku: Emisionet tematikë kishte vetë historia, kultura, gjuha rome; aksent shumë të madh kemi dhënë në bllokun që t'msojmë gjuhën rome. Përmes lojnave, lojës shpërblyese ku i jepnin katër-pesë fjalë të panjohura rome për popullatën, ata duhej të krijonin fjali. Atëherë më atë vellon përpara, atë barrierën që kishin romët, filloi të zbehej velloja dhe të tregoheshin si romë. Natyra misionare kryesisht ka qenë edukativo-arsimore. Qëllimi i emisioneve ka qenë për ta rritur ndjenjën apo ndërgjegjën e komunitetit rom ndaj identitetit të tyre, që mos të frigohen nga ngjyra, mos të frigohen nga paragjykimet e kështu me rradhë...

Ma tepër kemi dashtë të fokusohemi në çdo emision që pjesa ma e madhe të jetë foljore, ma pak muzikë sepse ne muzikën vetë e kishim në shpirt, e kishin në shtëpi, e kishim kudo, e kishim në gjep muzikën çdo herë. Qëllimi ka qenë të ngrisim nivelin intelektual të romëve, të ftojmë njerëzit të cilët sado pak kishin shkollat e mesme, ishin studentë në fakultete, të promovojmë studenta të cilët së paku kishin një background të mirë edukativo-arsimor poezi të kemi. Të defilojnë këngëtarë, të defilojnë kështu me

rradhë... Po edhe pas periudhës '99 vie në shprehje edhe ma tepër ku do të fokusohemi, nëse mundemi edhe në atë pjesë. Kjo ishte që kemi punuar... une kam punuar edhe për redaksinë rome, por paralelisht edhe për redaksinë shqipe sepse numri i gazetarëve ka qenë i vogël, edhe sjellja informata edhe në gjuhën shqipe për redaksinë.

Kam filluar atëhere në 2002-2003 të punoj edhe në media tjera të telivizionit turk "Yenidönem" në radio dhe televizion. Atëherë përplot e lanë, filluan t'i marrin emisionet e përditshme nga një orë ose dy. Karakteristika ka qenë që emisionet e natës i mbanin prej orës 12 në mbramje deri në 6 në mëngjes, edhe ndodhë një... nji ndodhi mjaft interesante ku brenda natës kisha...mbaja evidencën, emisioni kontaktues me telefon ka qenë apo... Deri në ora 6 të mëngjesit unë kisha mbi 180 dëgjues përmes telefonit. Mbaja evidencën, dy-tre ishim, dinim sa po na kërkonin. Të nesërmen drejtori i OSBE-së fton drejtorin tim në bisedë.

Para se të shkon drejtori im në bisedë me drejtorin në OSBE-së, më merr në telefon dhe më thotë "Çka ke bërë mbrëmë? Mos ke bë diçka?" Thom "Jo". Thotë "Kush është ai djalë i cili tërë kohën më ka majtë deri në ora 6 të mëngjesit?" (Qeshë) Sepse i bënim emisionet në gjashtë gjuhë, romisht, boshnjakisht, shqip, frëngjisht, anglisht, kushdo që lajmrohej kishim donatorë shumë deri kur atëherë furra ... e nuk më kujtohet emri i furrës, na sillte toplinë në mëngjes dhuratë, sepse e manin n'mend edhe furrëtarët në mëngjes dëgjonin emisionet tona. Emisionet kanë qenë jashtëzakonisht të dëgjuara me përshëndetje dhe urime. Me ceremoni... akte të ceremonive të ndryshme, qoftë të synetisë, qoftë të martesës, qoftë të fejesës, edhe para lufte edhe pas lufte, redaksia rome pothuajse ishte rekordere e urimeve.

Ne i çalonim edhe lajmet kur i kishim... pa lajme sepse njerëzit kanë martesa edhe vinte njëri dhjetë urime, 15 urime. Na u duhej terminet të cilat i kishim të ndara për përshëndetje dhe urime të zgjateshin tre-katër-pesë herë më tepër vetëm që dëgjuesit tanë të jenë të kënaqur. Televizioni vije, Ballkan TV, Yenidönem, atëhere edhe në televizion kemi filluar të prodhojmë programe jashtëzakonisht të mirë me lajme me informacione të përditshme duke anashkaluar lajme të sistemit paste-copy. Ato s'i kemi dashtë asnjëherë, çdo herë kemi shkuar në sistem që t'i marrim informatat që i intereson romëve.

Nji ndodhi tjetër në televizion... ndodhemi para kamerave, është magji! Ne kishim promterin ku gazetari apo udhëheqësi i emisionit lexonte me germa të mdhaja, dhe publiku nuk e din aspak që ju lexoni. Lajmet tona zgjatnin 15-20 minuta. Ndodhi një gabim teknik në regji, unë bëhem gati, futem në emision, rregulloj kravatën time, pres shpicën, vije shpica e emisionit, përfundon shpica unë në promter shoh komplet emisionin, titrat në gjuhën shqipe. Ishte ditari i shqipes, i redaksisë shqipe. Çka tani të bëj? (Qeshë) Ju më besoni që ndoshta me dy gabime kam parë në gjuhën shqipe, kam folë në gjuhën rome, ku drejtori, regjia tanë kohën përmes dëgjuses "A po mundesh ende me vazhdu?" Po thom {pohon me kokë}... i jepja ndonjë sinjal, kishim një sinjal kur lapsin kishim në dorë, kuptoheshim me shokun, lëvizja lapsin do t'thosha "A osht' mirë!" Pamjet komplet ishin të shqipes, ne jemi mundu që zëri të cilin e kam inçizu në pamje, t'mos shkojë zëri... po t'flas unë mbi pamjen. Në gazetari duhet të jeni të përgatitur për çdo gjë. Dhe emisioni u kry e tha "A është e mundshme?" Kjo më ka ndihmuar që unë paralelisht t'i thithi të gjitha gjuhët ku jetoj sepse mund të ndodhë çdo gjë.

Pastaj filluan edhe tutorimet e mija në Europë në 2002-tën e shumë në Europë kemi qenë. Hera e parë pas lufte... edhe këtë dua t'ju tregoj. Unë kreva Akademinë e përshpejtësuar për aktrim edhe regji te profesor Faruk Begolli në Prizren këtu. Takova Jeton Neziraj ku bënim dramën e parë "Rruga në Unmikistan". Kam qenë një kohë autor i pjesës në gjuhën rome diçka. Njoftova Jeton Neziraj tani drejtor në Multimedia,

atëhere ishte drejtor Teatrit Kombëtar në Prishtinë, edhe më thoshte "A ke qenë në Prishtinë?" Po thom "Jo". Po thotë "A ke ndërmend me ardhë?" (Buzëqeshë) Po thom, "Pse t'vij në Prishtinë? Çka ka?" Po thotë "Ki me ardhë! Ke frikë". "Nuk kom frikë t'vij". "Ke frikë" "Nuk kom frikë"... Ai "Eja", unë "Jo!"

U detyrova nji ditë, i hypa autobusit edhe të qëndroj në karrigën e fundit në autobus, bleva katër-pesë gazeta. Takimi i parë ka qenë me kondukterin kur ai m'i kërkon të hollat për biletë, e paguj biletën, unë nji orë e gjysë apo dy kam lexuar vetëm gazetë që askush s'ma ka pa fytyrën. Kam hapur gazetën me paragjykim t'keq, po edhe me nji dozë frike sepse në 2003 nuk ka qenë lehtë për nji rom të udhëtojë, me ngjyrë t'zeza, plus të udhëton në Prishtinë.
Mu atëherë Jetoni më takon në Prishtinë, më shëtitë në rrugën Nënë Tereza, "Po ngrite kokën se edhe Prishtina është e jotja". "Ngrite kokën" kështu më thoshte edhe profesor Begolli dhe Jetoni edhe Enver Petrovci atëherë... fillova ta krijoj një shoqni jashtëzakonisht të mirë edhe unë fillova të thej atë barrierën-akullin në relacionin Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas.

Jeta Profesionale

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën për jetën e saj profesionale dhe karrierën.]

Kujtim Paçaku: U drejtova në Paris ku kam kry edhe romologjinë në Sorbonë. Kam qenë edhe jam sot e kësaj dite asistent jo i rregullt i katedrës së romologjisë ku tani këtë vit shkollor punon gjenerata e 14-të në baçelor dhe e treta në master të romologjisë. Kemi studentë nga mbarë Europa, vlen të përmendet edhe Masakoja, studente nga Japonia e cila e flet perfekt gjuhën rome. Kemi studente nga Franca, kemi pasë nga Shqipëria, Kosova dhe shtete tjera, ku msojnë gjuhën rome po paralelisht kanë të drejtë të studiojnë edhe në gjuhën tjetër, sikurse unë kur isha në 2002, kreva kursin e civilizimit françez -Cours des civilisations - për të pasur mundësi për tu punësuar apo studiuar. Nëse nuk e ke kursin s'mundesh të punësohesh sepse në Francë në Paris të jetosh, në shtetet tjera së pari duhet të i nënshtroheni procedurave françeze, përmes së cilës duhet ta njifni shumë mirë kulturën, gjuhën, traditat.

Pas kursit gjashtë mujor atëherë të fokusoheni në studime apo në punë. Edhe kjo më mundësoi që të qëndroj dy vite atje, t'punoj në mënyrë permanente. Që edhe prej fazës para luftës edhe pas luftës, unë kam qenë gazetar korrespondent në shumë gazeta dhe media europiane, pothuajse në të gjithat, në Poloni, Sllovaki, në Çeki, në Austri, në Paris, në Shqipëri. Pastaj fillojnë edhe botimet të cilat i kisha unë në fletoren time të poezive. Preokupim çdo herë i imi ka qenë se si t'i shmangemi ngjyrës. Shumë pjestarë të komunitetit… kur kam bërë unë studime në disa projekte, për shembull në Prizren edhe 18 fshatëra, 12 fshatëra të Prizrenit duke i fokusuar fëmitë në 18 fokus-grupe - "Pse nuk shkon në shkollë?" "Cili asht problemi i shkollës?" "Fëmiu rom në rrugë". "Fëmiu në polici". "Fëmiu në spital". "Fëmiu te mjeku". "Fëmiu në shkollë". "Fëmiu në oborr të shkollës." - 18 fokus-grupe edhe nga ajo kam marrë materiale shumë, që së pari ne kemi auto-paragjykime të cilat krijojnë problem shumë të madh, pastaj paragjykimet mbi ne të cilat i bëjnë pa na njohur askush.

Filluan botimet e para, deri më sot. Nëse flasim për poezi, kam vepra ku jam si ko-autor i librave, qoftë për tekstet parashkollore të fëmive romë, të teksteve shkollore edhe librat individuale si poet. Jam ko-autor i teksteve, për shembull "Klyshi i vogël shkon në shkollë. Ku është klyshi ynë?" Është nji grup autorësh e kështu me rradhë për fëmijët parashkollorë ku tekstet janë bilinguale në gjuhën frënge, angleze dhe rome. Më pas kam punuar "Përrallat rome" me Mina Çiriçin nga Shqipëria ku jam përkthyes i tij prej

shqipes në romishte. Ka tekste tjera ku kemi bërë pjesën e dialekto-metodologjisë të gjuhës rome përmes poezive të cilat janë botuar qoftë në antologji, unë jam futur sot në tekstet e punës së studentëve. Eh, kur kam ligjëruar orën e parë me studentët e mi në Paris… çdo herë ndodhë diçka interesante tek unë (qeshë). Më besoni, pa dashje ka qenë që atë ditë temë e mësimit ka qenë "Kujtim Paçaku, shkrimtar". Askush nuk më ka njoftë prej studentëve kur kam hy n'klase e po e mbaj orën e parë.

Bëj shtjellim të emisionit, bëj hyrjen e emisionit që... "si ju ka treguar profesor Kortia Dechia, edhe unë sot... dje keni mësuar për Breslav Papushën, është shkrimtar nga Polonia. Eh sot një shkrimtar nga Kosova..." Unë nuk i kam treguar as nga jam, k'té e kam lënë si befasi sepse nëse do t'thosha që jam nga Kosova, do ta dinin. E çka më pas po ndodhë? Shënova Kujtim Paçaku u lind në Duhël edhe pikëpytje se kumedit kur vdes ky njeri (buzëqeshë). Edhe tregoj për veprat e mia e kështu me rradhë, e kështu me rradhë, e kështu me rradhë...Përfundoi ora e nji studente më pyeti "Po ju s'na treguat kush jeni, nga jeni" (qeshë). Po thom, "Unë jam atë që kemi mësuar sot dy orë t'plota për veprat e tij". Po thotë, "Me shumë dëshirë, në provim kur t'hyj tek ju, kam dëshirë kjo pyejte e juja me qenë sepse keni bërë nji shpjegim detaj, nuk ka pas aso detaje për Breslav Papushën apo Motrat Dudarova apo për Ali Krasniqin, apo për Orhan Galushin. Apo për Santino Spinelin apo për shkrimtarë të tjerë të cilët shkruajnë". Unë kam dhënë detaje se s'e kam pas aspak vështirë t'i tregoj se djali i kujt asht' Kujtimi, çka ka bërë në shkollën fillore, kur ka shkrujtë... do t'thotë kanë qenë detaje shumë ma t'lehta për mu; ajo ka qenë shumë interesant në orën e parë.

Ku më pas në Paris fillon rilindja ime e poezisë, ta kontaktoni nji poet rom, të flisni me të, dhe ta shikoni në sy drejtë… poezia e atij shkrimtari do t'përbëjë disa elementeve: lirisë, zjarrit, ujit, diellit, dashurisë së dështuar. Këto janë ato që poeti din ta vajton, një dashuri të dështuar. Poeti i mirë rom din ta nxjerrë prej vorrit nji dashuri të dështuar dhe ta ringjallë. Din t'i këndon diellit, din yjeve t'i këndon, din identitetit t'i këndon, këto janë elemente që rrallë herë mundemi... asnjëherë nuk haseni... poeti rom këndon shumë rrallë për shtetin e tij, për luftën e tij, për flamurin e tij i cili është ngulë diku në Himalaje dhe thotë, "Deri këtu është e imja!" Është zemërgjerë poeti çdo herë sepse na nuk kemi vend ku themi, "Aha! Ky është vendi im. Është shteti im e tani... më ngadalë pak". Adaptohemi shumë shpejt rrethit ku jetojmë.
Të kthehemi në Paris, atje botoj një libër në gjuhën frënge-rome. Bën një ekspanzion, një ekspanzion të madh, libri në shtëpinë botuse "L'Harmattan", ku përmes ambasadës sllovene kemi bërë mbrëmje të poezisë franko-rome, duke vizituar ambasadat. Kemi filluar me ambasadën polake për të mbaruar me një ambasadë të Kilit apo Brazilit. Dikun çdo mramje kishim mramje të poezisë, qoftë në objekte të mbyllura si ktu, qoftë jashtë, qoftë kur ngelnim pa para me shokun tim Jean Philipe Raymond, aktor i mirë i Teatrit Chatelet, këndonim para katedrales... katedralave në Paris dhe fitonim para. Ai recitonte në gjuhën rome, ma mirë po themi ai këndonte romisht... unë këndoja romisht, ai frëngjisht, por recitonim. Duke pasur nji asi… Kur mbaronte programi jonë 20 minutësh, ai nxjerrte edhe pshhh {tregon me duar si mbledhnin të hollat me kapelë} t'gjithë jepnin para. Kjo ishte që kemi bërë mbi 10-15 mramje të poezive nëpër qendra të ndryshme kulturore.
Filluan filmat dokumentarë, gjatë qëndrimit tim në Paris, kam udhëhequr edhe një emision në gjuhën rome Radio Shutka e Maqedonisë. Kam punuar në Radio Protestante ku emisionet javore...

Kaltrina Krasniqi: Cilat vite janë?

Kujtim Paçaku: Këto janë pas luftës, në Radio Protestante kur ekskluzivisht drejtori ka kërkuar të kemi poezi vetëm poezi në gjuhën rome dhe frënge. Do t'thotë kam qenë edhe pjesë e Radio Protestante, në Radion e Romëve... Edhe filluan bienalet e ndryshme të Parisit. Kthehu në Kosovë, shko në jug të Francës,

Festival i Poezisë, kthehu në Kosovë, shko në Tulluzë në mramje të Parisit, kthehu në Kosovë, shko në Paris, shko në Itali. Në '94 edhe '97 harrova t'ju them jam kampion... (qeshë) kam zënë vendin e parë, ma mirë me thënë, m'ka takuar vendi i parë për poezi. Është festival ndërkombëtar i romëve në Lanciano në Chieti të Italisë, afër Peskarës, në 18 kategori të filmit, muzikës e kështu me rradhë.

Unë dy herë kam marrë për poezi vendin e parë. N'mesin e tyre ka qenë edhe poezia e paevitushme, "Ngjyra". T'ju them se poezitë e mia janë përkthyer mbi 12-13 gjuhë botërore edhe në gjuhën kineze. Por "Ngjyra"... askush nuk e ka evitu "Ngjyrën". E kanë pëlqy "Ngjyrën" sepse kemi menduar... unë kam menduar që përmes poezisë "Ngjyra" do t'i them së paku paragjykimet. Ngjyra e zezë a po?... që na karakterizon (qeshë). Do t'i them paragjykimet, auto-paragjykimet që unë jam i zi s'guxoj të takohem me Jetën {i referohet intervistuesës}, Jeta ma e bardhë se unë... Pse jo, kur Jeta më pranon si shok shumë t'mirë? Unë po ashtu mundohem që atë që marr nga Jeta ndoshta dyfish t'ja kthej edhe më mirë, kështu të krijohen relacionet njerëzore çka na mungon. Jo vetëm në relacionet unë-Jeta, munet me qenë unë dhe Jean Philipe Raymond i cili është i përpultë si unë... ngjyrën e ka. Po, nuk i kanë ato paragjykimet si ne në Ballkan që i kemi.

Prej periudhës së pas luftës unë kam qenë edhe dy mandate këshilltar i ish-presidentit të Kosovës, profesor Fatmir Sejdiut. Deshe apo nuk deshe të mirresh me politikë, ajo do t'merret me ty. Ne bëjmë politikë atëherë edhe kur nuk dijmë që jemi duke bërë politikë, edhe fëmiu babait i bën ndonjëherë politikë apo anasjelltas. Më besoni se ajo edhe është poltikë. Por të `bësh politikë për një komunitet, është atëherë lojë e hapur në politikë kur kërkon të drejtat, integrimet, të aplikohen ligjet e propozuara, ligjet aktuale, të kërkohen nji rimëkëmbje të komunitetit tënd sikurse që janë komunitetet tjera, të cilëve iu ofrohet të drejta çdo gjë përmes ligjit, asgjë ma pak, por edhe që vie ma shumë, i thu, "Faleminderit! Këtë e kthej", por ma pak jo.

Politikë është kur komunitetit rom i ipen të drejtat për shkollim sikurse komuniteteve tjera në gjuhën rome, askush nuk na mohon këtë. Ne mund ta kemi sistemin fillor, ku unë kam bërë kurrikulën për nxënësit e komunitetit rom si pjesë e ekipit të kurrikulës në Ministrinë e Arsimit. Por, pak kemi mësimdhënës të cilët do t'përvishen... kuadri është i vogël, që do t'përvishen t'i mësojnë fëmitë në gjuhën rome që të mos asimilohen. Ajo ka qenë nji politikë që gjatë, qëndrimit tim si këshilltar i profesorit Sejdiu. Kemi bërë një kuotë të studentëve për numrat e rezervuara në fakultete, që ka qenë shumë gja e mirë. Nuk mundemi as t'i plotësojmë ato kuota sepse nuk kemi çdo vit dhjetë studentë në medicinë t'i fusim të komunitetit rom, apo në fakultete, por sa kanë nevojë aq që studenti të ndihet komod. Gjatë qëndrimit tim si këshilltar i presidentit Sejdiu kemi arritur të bëjmë negociata me Roma Education Fund në Bullgari, ku kemi përcaktuar edhe bursat për pjesëtarë të komunitetit rom.

Është politikë edhe kur ti si rom, si aktor i mirë bën politikë e Jeton Nezirajt i thua, "Po!" Tani duhet të shkruash nji gjë aktuale se si romët depërtojnë me dhunë nga shtetet e perëndimit ku Jeton Neziraj me lapsin në dorë, edhe në bashkëpunim me mua, bën këtë dramën tragjiko-komedi e cila ka bërë bujë në Europë "Yue Madeleine Yue". Tregon realitetin romët diskriminohen në shtetet e perëndimit, ashtu të diskriminuar, i sjellin këtu në Kosovë edhe këtu 12 apo 15 fish ma tepër diskriminohen romët edhe tregon një realitet. Lunacek, një politikane e Këshillit të Europës më takon në Vjenë në Volkstheater pas shfaqjes dhe më thotë... unë i them "A të pëlqeu shfaqja?", ajo më thotë "Jo, asesi!" Po thom "E çka?", tha "Nuk e kam ditë aq që jeni të vujtur" dhe po thotë "Nuk di si ke mujtë të qëndrojsh një orë e 10-15 minuta në skenë edhe t'i duron të gjitha peripetitë që ndodhin". Peripetitë e shfaqjes, si ka mujtë nji babë sepse ta

shantazhojnë vajzën, djalin... Jeton Neziraj e ka bërë atë në mënyrë mjeshtërore për t'i treguar të tjerëve se si manipulohet dhe diskriminohet ky komunitet.

Pozita ime si këshilltar i profesorit Sejdiu më bën që edhe të futemi në zgjedhje politike. Unë s'e kam dashtë këtë profesion, nuk di edhe të tjerët sa e dojnë, por kam menduar se arma kryesore për ta goditur politikën e gabuar në kokë, është kultura. Unë këtë material e kam nga kultura besoj, jam i njohur në çdo lagje të Kosovës. Çdo lagje më njeh si Kujtim Paçaku, hajde të themi edhe të Ballkanit. Unë jam i njohur edhe në Bratislavë në rrugën e romëve, edhe në Tiranë shembull në lagjen "Nikua Avrami". Është nji lagje shumë e madhe ku kam punuar fjalorin e parë në gjashtë gjuhë në 2003 duke inkorporuar për herë të parë gjuhën shqipe në atë fjalor. Jam i njohur në lagjen të Bullgarisë, në Sofie më njofin të gjithë fëmijët, vrapojnë pas meje, bëjnë muzikë, shoqnohem me ta, apo në Paris në lagjen e romëve apo në Tulluzë apo Instanbul e kështu me rradhë.

Kam krijuar një reputacion të mirë, çdo herë kur kam shfrytëzuar kulturën si armë për ta goditur politikën e gabuar e cila drejtohej mbi romët apo për romët. Tani jam deputet në Parlamentin e Kosovës, përfaqësoj komunitetin rom, para dy vitesh kam magjistruar edhe në pedagogjinë e muzikës. Pothuajse jam magjistri i parë i diplomuar. Mjerisht, po pres që edhe kolegët e grupit të diplomojnë, jam i vetmi për momentin që kam diplomuar me notën maksimale dhjetë. Kom punuar në mënyrë serioze në diplomën time, pres të bëj doktoraturën, jam në negociata me Universitetin e Bullgarisë Kiril dhe Metodie ku dëshiroj të bëj doktoraturën në një fushë specifike në etno-muzikologji, muzika e vjetër qytetare rome, ku krahas kësaj kam harruar të ju tregoj që kam formuar edhe oktetin e parë në Europë. Oktet, i cili këndon akapella nën dirigjimin tim. Këndojmë këngët e vjetra qytetare rome të cilat janë kënduar në Kosovë para tre qind apo katër qind vitesh, sepse derisa ishte pytja me vend, "Çka keni punuar ju me emisione nga '86-ta?" unë harrova të ju tregoj.

Tani më ra n'mend, unë çdo herë kur kam biseduar për doket zakonet, dasmat e romëve, i kam pyetur pleqtë, "Po mirë, a keni kënduar ndonjë kangë ndonjëherë?" Ka qenë ajo për ditën e mirë edhe pse kemi biseduar për shembull për ceremonitë mortore. Po thom, "Hajde plakë na këndo edhe një kangë..." Na këndonte kangën "Of, of do të vdes. Nënë moj, si do të futemi në nën dheun e zi?" E po thom, "Prej nga këtë kangë?" Nëna Besë ma këndonte, nji gru e cila ka jetuar mbi një qind vjet. Ajo më thoshte, "Eh këtë këngë ma ka mësuar gjyshja ime, djali im". "Po a? E gjyshja yte prej nga?" "Prej gjyshes së saj". Kur para vetit në bisedime kemi nënë Besmën me një qind vite, gjyshën e saj ka jetu edhe një qind edhe gjyshja e saj mbi dy qind, del kanga që i ka afro tre-katër qind vite, që tregon se romët në Ballkan janë afro shtatë shekuj, shtatë qind vite këtu, prej migrimit të tyre nga pjesa veriore e Indisë së Epërt... po hyjmë në histori tash (qeshë).

Kemi sjellur mjaft nga India. Vajzat tona kur shkojnë nuse vejnë bëjnë natën e kanës. Kur lidhin ca pejë... unë di t'i lexoj disa shenja të cilat përmes kanës dalin si figurë. Janë shenja të cilët romët i kanë sjellë nga India, janë afro 19 hieroglife të cilat shkencëtarët ne e kemi zbuluar që janë hieroglife të sjellura nga India, këtu. Ato hieroglifet i gjejmë në kanë. Ka hieroglife për shembull, është një zero dhe nji pikë n'mes t'zeros, thotë "Këtu mos pini ujë!" Apo një hierioglif tjetër është, "Këtu nuk japin ndihma!" për ta kuptuar grupi i dytë i cili vje në atë fshat që si asht' gjendja e fshatit. Ata kanë bo gravurën në gur, në dhe, në dru që grupi tjetër i cili ka ardhur në fshatin gjegjës, ka ditë, ka parë shenjën, ka thënë, "Aha, këtu japin ndihma. Këtu po pushojmë". Apo, "Këtu s'japin ndihma, e kanë mytë dikend edhe nuk i ofrohet". Domethonë janë 19 hieroglife. Ky osht' kontribut lokal i romëve prej grupit në grup.

Kur flasim për kontributet atëherë duhet cekur patjetër se kultura ka fuqinë ma t'madhe ta godet politikën në kokë. Politikën e gabuar në kokë! Është kontribut i romëve në muzikë edhe në ekonominë e vogël, sidomos në Prizren. Këtu ka ekzistuar një orkestër "Çergagjitë e Prizrenit" të cilët formacioni ishte i përbërë prej romëve, gjithë romëve. Ata në vitin '45 kur krijohet Radio Stacioni i parë i Kosovës ishte Radio Prizreni dhe shpisë gjenerale të televizionit ishte shpisë që ekzekutonin "Çergagjitë e Prizrenit". Keni parasysh se çdo ditë hapja e programit të një institucioni bëhet me romët. Më pas, ka dokumente ku Fan Noli i madh spjegon në mënyrë decidive për kulturën dhe muzikën rome. Këte pak e hasim prej shkrimtarëve të tjerë që e kanë bërë.

"Zotëri a doni qymyr?" ose "Luli i vocërr", të gjithë po e dijmë, askush nuk e ka menduar po kush është ai Lul. Si don ta gëlltitë mësuesin me këpucët e tij, a mund të jetë rom? Migjeni nuk e ka spjeguar këtë. Ose kontributi i romëve si muziktarë ku opusi i pikave muzikore ka qenë i njëjtë, pothuajse prej njëzet apo tridhjetë pikave muzikore, edhe romët bënin muzikë. Atë opus muzikor e derdhnin apo e ekzekutonin tek romët, të njejtin te shqiptarët, të njejtin tek serbët, të njejtin tek turqit (qeshë). Shiqoni, një muzikë e njëjtë, po ekzekutohet prej romëve por në shumë grupe të komuniteteve. A dini çka ka ndodhë këtu? Këtu ka ndodhë që vallja "Shota" është ekzekutuar nga romët tek serbët, edhe serbët e kanë vallëzuar "Shotën". A e dini këtë? Shiqo çfarë kontribut indirekt, i padukshëm.

Romët kanë qenë bartësit kryesorë të muzikës, që përmes muzikës i kanë lidhë komunitetet, ose tek turqit kanë luajtur valle t'bullgarëve t'cilat i ka vallëzuar komuniteti turk. A e dini çka është më interesante? Edhe gratë e kanë vallëzuar këtë. Po të njejtën edhe romët e kanë vallëzuar tani. Të njejtën romët e kanë vallëzuar edhe "Shotën". Shiqoni, romët si orkestër sa bartës të mirë të kulturave muzikore, ku asnjë komunitet nuk ka thënë "Jo, jo nuk e dua Shotën!", asesi. Do t'thotë romët kanë qenë bartës kryesorë.

Shembulli i dytë, ndoshta gjenerata juj është pa informacione kur njerëzit kanë shkuar ushtarë, të rinjtë, në armatën popullore të Jugosllavisë të atëhershme. Asnjë ushtar nuk ka i është drejtuar autobusit apo trenit pa muzikë. Ka qenë çudi që t'shkon nji ushtar pa muzikën e romëve. Këtu në Prizren zakonisht ka qenë shumë aktuale të shkon me muzikë ushtar... t'i drejtohesh stacionit të trenit. Është tjetër, nji shembull tjetër që institucionet kulturore të Kosovës, qoftë para lufte, apo pas lufte, asnjë orkestër, asnjë shoqatë muzikore nuk ka mundë të ekziston pa romë, qoftë "Shota", ku dy-tre muziktarë kanë qenë romë, edhe pse instrumentalë profesionelë, qoftë orkestri i Radio Prishtinës, qoftë Shoqnia "Agimi"...

Lufta

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarin për kohën e luftës.]

Kujtim Paçaku: Lufta ka qenë tmerr. Është vështirë kur ndodhesh në mesin e dy zjarreve. Ai sistem ka qenë ku kemi qenë në nji pjesë. Ka të kthehesh, topi... do të jesh i goditur. Për komunitetin rom ka qenë shumë i vështirë, edhe pse duhet të flitet realisht që kontributi i romëve nuk ka qenë i vogël aspak, duke i ndihmuar edhe popullatën kosovare në një mënyrë ose mënyrën tjetër. Çdo herë kur je pakicë në mesin e luftërave, për ne lufta është nji gjë shumë e padëshiruar sepse humb shokun, humb fqiun, kushdo i cilit nacionalitet të jetë.

Në Prizren kemi jetuar të gjitha komunitetet së bashku, por ja vie deri te ajo që e paevitushme ishte lufta, atëherë shumica e popullatës edhe para luftës edhe gjatë luftës edhe pas luftës kanë migruar në shtetet tjera, edhe pse prej vitit '69 fillun migrimi i romëve në shtetet tjera për shkak se atëherë në mënyrë legale

kanë migruar romët në shtetet e jashtme përmes Entit për Punësim. Kanë migruar dhe kanë qëndruar atje.

Periudha pas luftës ka qenë e vështirë, po të gjen punë, po t'i gzohesh lirisë t'Kosovës, sepse ne romët jemi gëzuar... i tregova Jetës unë... ma vonë se të gjithë. Në qoftëse tërë Kosova është gëzuar në qershor të vitit '99 për çlirimin e Kosovës, ne jemi gëzuar tri-katër vite më vonë, sepse ka pas shumë partizanë të cilët nuk kanë dhënë aspak ndoshta kontribut luftës kosovare. Ne e dimë atë shumë mirë, edhe ju e dini. Kemi biseduar me Jetën paraprakisht... do t'bisedojmë për politikë deri kur e vejmë dorën në ringëll të shporetit. Kur t'fillon të djegë dora (qeshë), do ta hekë menjëherë.

Ato çka ka ndodhë në luftë, nuk guxojmë t'i harrojmë. Por duhet t'i kujtojmë ato me kokë përpara për të filluar ta zhvilluar Kosovën. Domethënë, ne kemi qenë ata që më së voni jemi gëzuar lirisë. Më së voni sepse gjuha, informatat e gabuara të marrura ad-hok mbi romët kush kanë qenë. A kanë qenë bashkëpuntorët e serbëve, apo nuk kanë qenë bashkëpuntorët e serbëve. Asnjëherë, as serbët sot nuk flasin që romët kanë qenë bashkëpuntorë të tyre. As shqiptarët nuk flasin mbi romët që kanë dhënë kontribut për shqiptarët. Ne e dijmë me emra, shumë romë kanë dhënë kontribut shqiptarëve në luftë, por pak është promovu kontributi i romëve. Por mos t'flasim për luftë…

Poezia

{Reciton poezinë "Ngjyra"}

Ngjyra

Pse frigohesh, pse fshihesh?
Të vjen turp nga ngjyra e lëkurës tënde?
O njeri!
Edhe ty, edhe mua, edhe ata të tjerë
Na ka krijuar Zoti.

Dëgjo!
Nën ngjyrën e lëkurës tënde
ke të fshehur një ylber,
mu brenda shpirtit tënd.
Andaj, kokën lart!

Këtë e ka thënë edhe profesor Petrovci në gjuhën rome. Çka është shumë interesante që unë në poezitë kam arritur të bëj një animacion, edhe zonja Nexhmije Pagarusha edhe profesor Enver Petrovci edhe të tjerët ata të recitojnë në gjuhën rome, unë të recitoj në gjuhën shqipe. Profesor Enver Petrovci reciton jashtëzakonisht mirë poezitë në gjuhën rome. Ai për herë të parë, në gjuhën rome e recitoi poezinë "por ja vije deri te ajo, edhe thotë {reciton poezinë "Unë"}

Unë.

Po po, jam rom!
Unë që tani qëndroj para jush,

jam nga stërnipat e Gangut
e bijtë e Lumbardhit.
Flej nën Himalaje apo flej nën Sharr,
kudo që të jetë.

Është e çuditshme
që asnjëherë nuk isha
tamam i bardhë për të bardhët,
as boll i zi për të zinjët.
Unë erdha vetëm për t'ju falë ca vargje.
Të marr ndonjë duartrokitje në këmbim,
dhe aq më mjafton të jem i kënaqur me ju!

Prej shtatë-tetë titujve, libri i kaluar ishte "Rreth zjarreve". Në atë libër kemi bë dasëm. Kur ju më keni pyetur çka zakonisht përmbajnë poezitë e juaja, me këtë poezi kam vendosur të bëj dasëm (buzëqeshë). Është një lindje e romëve, është një zhvillim i tyre, është një etapë e martesës së tyre, dasmës së tyre. Edhe në fund e kam lënë qëllimisht një poezi se si ne i përcjellim mysafirët edhe themi FUND.

{Reciton poezinë "Fund"}

Ja pra ky është fundi ynë.
Hamë e pimë aq sa na ka dhënë Zoti.
Hajde, e u pafshim veç për hajër!

Kështu ne i përshëndesim mysafirët - sa na ka dhënë Zoti (qeshë). Është e shkurtë, por e cila ka një mesazh jashtëzakonisht të madh kur ne përcjellim mysafirët prej dasmës që shkojnë.

Ëndrra

[Pjesë e prerë nga video-intervista: intervistuesja e pyet të intervistuarën se cilat ishin ëndrrat e tij.]

Kujtim Paçaku: Ëndrra! Në aspektin e filozofisë, të zgjatë tre-katër-pesë sekonda derisa je në gjum... çdo gjë përfundon. Ajo jep shkak që ju të kërkoni zhvillimin e saj, ëndërra të cilin gjatë gjumit jeni ballafaqu me te. Keni qenë vrapues i dobët në ëndërr, asnjëherë s'keni mujtë ta bëni ndonjë hap ma shumë (qeshë) se dikush tjetër. Keni bërë dashuri me dikënd, jeni zgjuar... trshtim! Nuk është e vërtetë. Keni parë ëndërr nëna e juaj e cila kaherë ju ka lënë dhe ka shkuar në qiellin e shtatë, jeni ngritë, nuk e keni pasë më.

Ah jo! Kjo, është e gjumit. Ndërsa, kjo e realitetit tek unë nuk ka fund. Ka fillim, por unë jam lindë. Ne e kemi traditë kur lindemi, nëna apo dikush tjetër na këndon nji dovë nga Kur'ani dhe na vë një emën në vesh (buzëqeshë). Etapat e ndryshme... edhe pse jeta sipas meje, hajt të flas si intelektual, pesë etapat e lindjes, të zhvillimit nji etapë, nji etapë e martesës, rritjes, plakjes edhe i thu "Tungjatjeta". Ne i themi në Prizren Bağrem Bahçe, a din... (qeshë). Por, asnjëherë ëndrrat e nji intelektuali real, e nji shkrimtari, e ëndrre e nji artisti nuk përfundon edhe në ditën e fundit kur është personi i mbështjellur në çifin edhe kur i këndon hoxha mi kokë. Është e papërfunduar sepse ai mendon që në jetën e amëshuar, do ta vazhdon jetën me 72 bukuroshe të cilat e presin me verë të kuqe. Ajo vazhdon tek unë ende, sepse ëndrra ma e

madhe e imja është që të kem diçka që nuk kanë të tjerët... shokë shumë edhe shoqe. A din çka do t'thotë kur ju keni shokë e shoqë shumë, ju jeni njeri më i pasur në botë. Paraja është zero, pikë zero, zero, zero për njeriun i cili është i shëndoshë në kokë. Për njeriun i cili ka zanafillën, ka fidanishtën e familjes së shëndoshë. Paraja nuk e ndërton njeriun! Kanë shumë që dojnë të jetojnë në Paris, të jetojnë në Prishtinë, të jetojnë në Kamboxhë, të jetojnë në Itali, në Romë e kështu me rradhë. Jo, jo!

Ato realizohen, por unë kam dëshirë të kem shumë poezi. Ka qenë një prej pjesëve të andrrave të mija, t'i lo dy qind- tre qind poezi që unë kur të vdes, nuk do të vdesi kurrë. Definitivisht unë kur marr të shkruaj një poezi për shoqen time shumë të re, për Jetën, për ju, apo për dikë tjetër, ne do t'kalojmë dikund. Nuk do të shifemi në këtë botë, por dikush do t'shkojë në nji biblotekë të hapë një poezi e t'thotë, "Por kadal, ky njeri... Është…" ne e dimë që Dostojevski ka humbë, Tagora ka humbë, Nehru ka humbë, motrat Dudarova kanë humbë, Ana Ahmatova ka humbë, Naim Frashëri po, Migjeni po... por shiqoni sa janë gjallë me ne. Nji person i cili le në këtë botë diçka të pavdekshme, ai nuk ka vdekur kurrë!